EKSTRAKT I KUSHTEVE TË KONTRATËS SË SIGURIMIT
JETË DEPOZITARI

Në zbatim të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe Statutit e shoqërisë SiCRED sh.a., paraqesim si vijon ekstrakt të kushteve të Kontratës së Sigurimit.

Kontrata e Sigurimit Jetë Depozitari është kontrata me anë të së cilës, Siguruesi dhe i Siguruari bien dakord që kundrejt detyrimit të pagimit të primit të sigurimit në favor të Siguruesit, në përputhje me kushtet e sigurimit të përgjithshme ose te veçanta (nëse ka), Siguruesi do të dëmshpërblejë Përfituesin, në masën e parashikuar në këtë kontratë nëse vërtetohet rasti i sigurimit.

1.1. Përcaktime

a) Kushtet e kontratës për Sigurimin e Jetës së do të quhen "**Kushtet e Sigurimit**".
b) Kompania e sigurimit SiCRED sh.a. do të quhet "**Siguruesi**".
c) Personi fizik për jetën e të cilit do të bëhet sigurimi, do të quhet "**I Siguruari**".
d) Banka, e cila merr përsipër të sigurojë klientët e saj Depozitues me këtë kontratë sigurimi, do të quhet "**Mbajtësi i Policës**".
e) Personi fizik apo juridik që nënshkruan policën e sigurimit, do të quhet "**Kontraktuesi**"
f) Dokumenti që provon dhe rregullon kontratën e sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet "**Policë e Sigurimit**".
g) Personi fizik apo juridik që përfiton nga kontrata e sigurimit mbi bazën e vullnetit të shprehur në këtë policë nga i Siguruari, do të quhet "**Përfituesi**".
h) Vlera monetare që i paguhet Siguruesit në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit, do të quhet "**Prim i Sigurimit**".
i) Shuma maksimale e mjeteve monetare e përcaktuar në kontratë, që Siguruesi merr përsipër të paguajë me vërtetimin e rastit të sigurimit, do të quhet "**Shuma e Sigurimit**".
j) Humbja e jetës së të Siguruarit, si dhe paaftësia totale e përhershme, kur nuk bien në kundërshtim me përjashtimet e paraqitura në këtë kontratë, do të quhen "**Rast i Sigurimit**".
k) Humbja e plotë e aftësisë së të Siguruarit për të kryer detyrat në profesionin e tij, apo dhe çdo profesion tjetër dhe që ka nevojë për një përkujdesje të vazhdueshme të një personi të tretë, konfirmuar nga organi kompetent mjekësor pas mbarimit të periudhës prej 52 javësh, do të quhet **"Paaftësi e Përhershme e Plotë".**

1.2 E drejta për t'u siguruar

1. Kanë të drejtë të marrin pjesë në kontratën e Sigurimit të Jetës së Depozitarit, me cilësinë e të Siguruarit, të gjithë klientët e bankës, të cilët që nga momenti i lidhjes së kontratës së sigurimit e në vazhdim, kanë apo hapin një depozitë me afat pranë "Mbajtësit të Policës".
2. Nuk kanë të drejtë të sigurohen me kontratën e "Sigurimit të Jetës së Depozitarit" personat që nuk kanë arritur moshën 18 vjeçare, ose janë mbi 60 vjeç, që kërkojnë kujdes të përhershëm mjekësor, ose që e mbështesin jetesën në kujdesin e të tretëve.
3. Të Siguruarit që arrijnë moshën kufi kur polica e sigurimit është në fuqi, do të mbeten të mbuluar deri në mbarim të afatit të treguar në policën e sigurimit.

1.3 Përfitimet e Pagueshme

1. Kontrata e sigurimit të Jetës së Depozitarit mbulon:
   a) Rrezikun e Humbjes së Jetës së të Siguruarit për shkaqe Natyrore
   b) Rrezikun e Humbjes së Jetës së të Siguruarit për shkaqe Aksidentale
   c) Rrezikun e Paaftësisë së Përhershme Totale të të Siguruarit për shkak të dëmtimeve të rënda Aksidentale.

1.4 Përjashtime

Ky sigurim nuk mbulon "Rastin e Sigurimit" të shkaktuar nga:

1. Lufta (vetëm nëse është e shpallur nga organet kompetente), veprimet ushtarake, lufta civile, rebelimi, kryengritja e armatosur dhe akte terroriste.
2. Veprimi i armëve të shkatërrimit në masë si armët bërthamore dhe bakteriologjike,
3. Pjesëmarrja në ngjitje alpinistike, gjatë fluturimit me avion të çdo lloji (përveç kur udhëton vetëm si pasagjer), gjatë ushtrimit të sporteve dimërore, garave me kuaj, makina dhe motoçikleta etj.
4. Përdorimi i lëndëve eksplozive dhe korrozive , përveç kur është në përmbushje të detyrës profesionale.
5. Tërmetet, përmbytjet, zhvendosjet e tokës apo shpërthimet vullkanike.
6. Përfshirja e të Siguruarit në akte kriminale dhe veprimtari të paligjshme.
7. Vetëvrasja nëse ndodh në dy vitet e para të hyrjes në fuqi të kontratës ose në vitin e parë të riaktivizimit të kontratës.
8. Pjesëmarrja e të siguruarit në sulme apo veprime dhe kundërveprime të dhunshme të shkaktuara nga të tretët, vetëm kur vepron në kushtet e vetëmbrojtjes dhe nevojës.
9. Influenca e alkoolit apo përdorimit të drogës.
10. Akte dhe veprime të shkaktuara me dashje nga Policëmbajtësi, Përfituesi, Ortakët apo Trashëgimtarët ligjor në dëm të të Siguruarit dhe që ndikojnë në shkurtimin e jetës së tij.
11. Sëmundjet veneriane, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, virusi HIV dhe çdo sëmundje e lidhur me të.
12. Çdo lloj defekti fizik apo mendor pre-ekzistues, gjendje patologjike , sëmundje të diagnostikuara përpara marrjes në sigurim ose të lidhura me to, përveçse kur është deklaruar me shkrim nga i Siguruari dhe është pranuar nga Siguruesi.
13. Pasojat e një aksidenti të mëparshëm, për të cilën i Siguruari ka marrë trajtim apo konsulencë mjekësore brenda 12 muajve para fillimit të policës së sigurimit. Asnjë përfitim nuk do të paguhet nëse rasti i sigurimit ndodh për shkaqet e listuara më sipër.
14. Në rast të humbjes së jetës, Përfituesi nuk do të paguhet në rast se kufoma nuk gjendet apo nuk identifikohet saktësisht.
15. Dëmtimet apo sëmundjet për shkak të infektimit masiv pandemik dhe bioterrorizmit.

1.5 Paraqitja e Dokumentacionit për Trajtim Rast Dëmi

a) Me ndodhjen e rastit të Sigurimit, Përfituesi duhet të njoftojë Siguruesin duke specifikuar rrethanat e ngjarjes dhe pasojat e tij, si dhe të zbatojë të gjitha porositë e dhëna nga Siguruesi.

b) Për të gjitha pagesa e dëmshpërblimit që do të bëjë Siguruesi, duhet të dorëzohen paraprakisht këto dokumenta:
   I. Polica origjinale;
   II. Mjet i vlefshëm identifikimi;
   III. Çertifikata e vdekjes së të Siguruarit;
   IV. Skeda e vdekjes;
   V. Raporti mjeko-ligjor, për rastet e vdekjes aksidentale;
   VI. Dokumente të tjera që mund të kërkohen nga Siguruesi në varësi me ngjarjen e ndodhur;
   VII. Akti i trashëgimisë në rast se i Siguruari nuk ka lënë përfitues.

c) Shpenzimet për grumbullimin e dokumenteve nuk janë në ngarkim të Siguruesit. Siguruesi, pas dorëzimit të plotë të dokumentacionit, brenda 30 ditëve duhet të shprehet për pagesën e dëmshpërblimit.

d) Çdo pagesë dëmshpërblimi do të bëhet pranë mbajtësit të policës në favor të Përfituesit.

1.6 Taksat dhe Tatimet

a) Taksat dhe tatimet e detyrueshme sipas ligjit, janë në ngarkim të Policëmbajtësit dhe/ose të Përfituesve.